



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.43

19 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.163, datë 21.3.2007	Për disa shtesa në vendimin nr.515, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.....	1123
Vendim i KM nr.164, datë 22.3.2007	Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Ministrinë e Brendshme.....	1124
Vendim i KM nr.166, datë 28.3.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e koncesionit të formës “ROT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Amal” sh.p.k., për hidrocentralin vendor të Xhyrës, të miratuar me vendimin nr.486, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave.....	1126
Vendim i KM nr.167, datë 28.3.2007	Për një shtesë në vendimin nr.507, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimet për privacionet dhe humbjet, që i krijohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, të ndryshuar.....	1127
Vendim i KM nr.169, datë 28.3.2007	Për procedurën e dorëzimit të aktit të inspektimit dhe elementet e përmbajtjes së tij.....	1127
Vendim i KM nr.170, datë 28.3.2007	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2007	1129
Vendim i KM nr.171, datë 28.3.2007	Për përcaktimin e strukturës, statusit, kritereve të përzgjedhjes, uniformave, armatimit dhe trajtimit financiar të forcës së sigurisë	

	në anije dhe port, për portet e Vlorës, Shëngjinit dhe të Sarandës	1129
Vendim i KM nr.172, datë 28.3.2007	Për shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës “ROT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Wonder” sh.a., për hidrocentralin e Bogovës, të miratuar me vendim nr.609, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave	1132
Vendim i KM nr.182, datë 4.4.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien, me koncesion, të hidrocentralit “Labinot Mal-Elbasan” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1134
Vendim i KM nr.183, datë 28.3.2007	Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave në transportin rrugor	1135

VENDIM
Nr.163, datë 21.3.2007

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.515, DATË 19.7.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE,
NË VARËSI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, dhe të neneve 21, 27 e 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.515, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 13/1 shtohen pikat 13/2 e 13/3, me këtë përmbajtje:

“13/2. Për arsye të karakterit sezonal të krijimit të të ardhurave në QTTB-të dhe në Stacionin e Duhanit, Cërrik, pagat e punonjësve me kontratë dhe shpenzimet operative, të domosdoshme për krijimin e të ardhurave të planifikuara, në gjashtëmujorin e parë të vitit, të përballohen nga Buxheti i Shtetit. Shuma e përdorur për këtë qëllim të rikthehet në Buxhetin e Shtetit, pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.

13/3. Përjashtimisht për vitin 2007, gjendja e llogarive likuiduese të ish-instituteve kërkimore-shkencore, të trajtohet si e ardhur jashtë limitit dhe të përdoret për shpenzime operative. Kjo shumë të rikthehet në Buxhetin e Shtetit pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.”.

2. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Të ardhurat e krijuara nga ish-Instituti i Kërkimeve Veterinare, Tiranë (IKV) për periudhën 1995-2006, në shumën 96 000 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë) lekë dhe të ngrira në llogari bankare, të investohen për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe për transferimin e Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë (IKU) në mjediset e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë (ISUV).”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.164, datë 22.3.2007

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHETETËROR TË PUNËS ME MINISTRINË
E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me organet e Ministrisë së Brendshme, për të plotësuar misionin e vet, në ushtrimin e kontrollit për zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet.

2. Inspektorëve të Inspektoratit Shtetëror të Punës duhet t’u krijohen të gjitha lehtësitë e

nevojshme, për të realizuar kontrollin e personave, juridikë dhe fizikë.

3. Inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës kërkojnë bashkëpunimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, kur:

a) pengohen forcërisht nga punëdhënësit apo personat e autorizuar prej tyre, për të hyrë në mjediset e ndërmarrjes, për të ushtruar kontroll, në përputhje me legjislacionin e punës;

b) gjatë kryerjes së funksionit, jeta e tyre është në rrezik.

4. Organet e Policisë së Shtetit, në rastet e një ndërhyrjeje urgjente, pas marrjes së njoftimit, zyrtar apo gojor, nga inspektorët e punës së drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të inspektimit në punë, bashkëpunojnë me këta të fundit dhe me grupin e inspektorëve në ato subjekte, ku pengohet ushtrimi i detyrës së tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.166, datë 28.3.2007

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “ROT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË E MINISTRISË SË INDUSTRIJËS DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “AMAL” SHPK, PËR HIDROCENTRALIN VENDOR TË XHYRËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.486, DATË 10.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit të formës “ROT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “AMAL” sh.p.k., për hidrocentralin vendor të Xhyrës, të miratuar me vendimin nr.486, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.486, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe në tekstin e marrëveshjes bazë të koncesionit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “AMAL” sh.p.k., për hidrocentralin vendor të Xhyrës, fjalët “...Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës...” zëvendësohen me “...Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHITESË KONCESIONI PËR HIDROCENTRALIN XHYRË

Në Tiranë, sot më 14.3.2007, Palët:
OSHA, e përfaqësuar nga z.Zamir Stefani, me autorizimin nr.115/1, datë 22.2.2007 të METE-s
dhe
Shoqëria “AMAL” sh.p.k., Librazhd, përfaqësuar nga z.Arjan Hysenllari, me prokurën e posaçme, nr.rep.608, kol.1442, datë 14.12.2006,
me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:
Të lidhin këtë Marrëveshje shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “AMAL” sh.a., Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Xhyrës në Librazhd, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003.

HYRJE

Duke pasur parasysh që në marrëveshjen ekzistuese të koncesionit ka gabime teknike dhe mangësi në funksion të zbatimit të penaliteteve, për të realizuar monitorimin e duhur të ecurisë së objektit të koncesionit, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes.

Palët bien dakord që në marrëveshjen bazë të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Te titulli, rreshti i tretë i marrëveshjes së koncesionit e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “AMAL” sh.p.k. Librazhd, për rehabilitimin e hidrocentralit të Xhyrës në Librazhd, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.486, datë 10.7.2003 bëhet:

“Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, më poshtë referuar si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).”.

Neni 2

Në nenin 4 “Detyrimet e koncesionarit”:

- te paragrafi i parë, pika 2, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë: “Në hidrocentralin e Xhyrës, investimi prej 5.45 milionë lekë do të përfundojë brenda datës 30.6.2007”;

- në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me përfundimin e zbatimit të projektit rehabilitues mbi objektin e koncesionit, koncesionari është i detyruar që në fund të çdo tremujori, dhe sa herë e kërkon OSHA-ja, të raportojë me shkrim mbi ecurinë e punës në objekt sipas një formulari që do të dërgohet nga OSHA-ja.”.

Neni 3

Në nenin 9 “Programi i punimeve”, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2007 deri në fund të periudhës koncesionare, do të jetë jo më pak sesa prodhimi i përcaktuar në aneksin 1 në kolonën: viti 2005.

Ndryshimi i programit vjetor i prodhimit mund të bëhet me miratim të OSHA-së, në rastet e ndryshimit të parametrave teknikë të objektit.

Neni 4

Në nenin 14 “Kontrolli i përgjithshëm”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“OSHA-ja ushtron kontroll në objektin e dhënë me koncesion edhe gjatë kohës së shfrytëzimit, pas përfundimit të rehabilitimit të përcaktuar në këtë Marrëveshje. Kontrolli kryhet nga

persona të autorizuar nga OSHA-ja me qëllim që të verifikojë shfrytëzimin dhe prodhimin, sipas parametrave teknikë të objektit të dhënë me koncesion, si dhe kryerjen e remonteve të parashikuara në udhëzimet e shfrytëzimit të pajisjeve.”.

Neni 5

Në nenin 20 “Sanksionet”:

- paragrafi i dytë i këtij neni bëhet:

“Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 9, pika 2 të marrëveshjes së koncesionit “Programi i punimeve”, koncesionari do t’i paguajë OSHA-së, për çdo ditë vonesë,penalitetin 0,01% të vlerës së investimit të perealizuar, për çdo program rehabilitimi”;

- pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rast mosrealizimi të programit të prodhimit, të përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, koncesionari penalizohet me 0,01% të vlerës së prodhimit të perealizuar për periudhën raportuese.”.

Neni 6

Marrëveshja shtesë e koncesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet e përshkruara në nenet 1-6 më lart, kanë fuqi për të dyja Palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes bazë nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja shtesë e koncesionit mbahet në 7 (shtatë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja Palët.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
PËRFAQËSUESI ME AUTORIZIM
Zamir Stefani

Për koncesionarin
Shoqëria “AMAL” sh.p.k.
PËRFAQËSUESI ME PROKURË
Arjan Hysenllari

VENDIM

Nr.167, datë 28.3.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.507, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOMPENSIMET PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET, QË I KRIJOHEN PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHTETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.507, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Punonjësi i policisë, për periudhën e ushtrimit të detyrës shtesë të trajnuesit në terren, përfiton shpërblim mujor, në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për shumën 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Brendshme për vitin 2007.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.169, datë 28.3.2007

**PËR PROCEDURËN E DORËZIMIT TË AKTIT TË INSPEKTIMIT DHE ELEMENTET
E PËRMBAJTJES SË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akti i inspektimit është dokumenti, i lënë nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës, në subjektin e kontrolluar, ku përcaktohen:

- a) shkelja e vënë re;
- b) afati ligjor dhe masat, që duhet të ndërmerren për përmirësimin e shkeljes;
- c) sanksionet ligjore, që vendosen ndaj subjektit të kontrolluar.

2. Akti i inspektimit, i cili është sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, mban simbolin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe plotësohet nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës në të gjitha rubrikat e tij. Akti i inspektimit duhet të përmbajë:

- a) adresën e saktë, ku ushtron veprimtarinë subjekti;
- b) emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të subjektit;
- c) llojin e veprimtarisë;
- ç) numrin e sigurimit, shoqëror dhe shëndetësor, të punonjësve;
- d) datën e fillimit dhe të mbarimit të inspektimit;
- dh) numrin e inspektimeve, që janë kryer në këtë subjekt;
- e) shkeljet e vëna re, shoqëruar me referencën në dispozitat ligjore;
- ë) detyrat e lëna për marrjen e masave për shkeljen e vënë re, si dhe afatet kohore, për t’u përmbushur këto detyra;

- f) sanksionin ligjor, që vendoset ndaj subjektit.

3. Akti i inspektimit mbahet në 3 kopje, nga të cilat një kopje i dorëzohet subjektit, një kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe një kopje e mban inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës.

4. Akti i inspektimit nënshkruhet nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës, si dhe nga përfaqësuesi i subjektit ose personi i ngarkuar prej tij, në subjektin, ku kryhet kontrolli.

5. Në rastet kur përfaqësuesi i subjektit ose personi i ngarkuar prej tij refuzon të nënshkruajë aktin e inspektimit, ky i fundit duhet të shënojë se refuzon ta nënshkruajë aktin e inspektimit, si dhe të japë arsyen, për të cilën e refuzon atë.

6. Në rastet kur inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës vëren shkelje të legjislacionit të punës për mosdeklarimet e punëmarrësve në zyrën e punësimit dhe në Inspektoratin Shtetëror të Punës, këtij akti duhet t’i bashkëlidhet edhe lista me emrat dhe mbiemrat e punëmarrësve të padeklaruar.

7. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Inspektorati Shtetëror i Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



QARKU _____
RRETHI _____

Nr. _____

Data e fillimit të inspektimit: _____
Data e mbarimit të inspektimit: _____

Inspektimi numer

AKT INSPEKTIMI

Subjekti: _____

Punëdhënësi (Përfaqësuesi i tij): _____

Adresa: _____

Lloji i Aktivitetit: _____

Numri i Sigurimit Shoqëror sipas kontratës midis palëve: _____

Numri i Sigurimit Shëndetësor sipas kontratës midis palëve: _____

Rubrika I

Janë realizuar: _____

Nuk janë realizuar: _____

Rubrika II

Shkelje të evidentuara (referenca në dispozita ligjore): _____

Rubrika III

Detra për t'u realizuar me afate kohore respektive _____

Rubrika IV

Masë ligjore marrë ndaj subjektit për: _____

*Ky akt-inspektimi mbahet në dy kopje, një për punëdhënësin, një për inspektorin përkatës.
Bashkëngjitur këtij dokumenti do të gjeni listën (emer mbiemer) e punëmarrësve të padëklaruar
në Zyrën e Punësimit apo në ISHP të evidentuar gjatë inspektimit.*

Përfaqësuesi i Subjektit

(emer, mbiemer, firmë)
Refuzon firmën për: _____

INSPEKTORI I PUNËS

(emer, mbiemer, firmë)

VENDIM
Nr.170, datë 28.3.2007

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR
TË TELEKOMUNIKACIONEVE, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, për vitin 2007, në shumën 196 500 000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë, sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR
TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2007**

(Lidhja 1)

	Emërtimi	Lekë
Nr.	SHPENZIME GJITHSEJ	196 500 000
1.	Paga	52.523.178
2.	Sigurime shoqërore	8.500.000
3.	Materiale	4.800.000
4.	Shërbime	24.576.822
5.	Investime	106.100.000

VENDIM
Nr.171, datë 28.3.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS, STATUSIT, KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES,
UNIFORMAVE, ARMATIMIT DHE TRAJTIMIT FINANCIAR TË FORCËS SË SIGURISË
NË ANIJE DHE PORT, PËR PORTET E VLORËS, SHËNGJINIT DHE TË SARANDËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forca e Sigurisë në Anije dhe Port, për portet e Vlorës, Shëngjinit dhe të Sarandës (FSAP), organizohet në varësi të drejtorit të shoqërisë anonime, Porti Detar, sipas strukturës në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Shoqëria anonime, Porti Detar, në varësi të rritjes së volumit të punës në port, ka të drejtë

të rrisë ose të zvogëlojë numrin e punonjësve të FSAP-së.

2. FSAP-ja zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me konventën SOLAS, 74, dhe amendamentet e saj, (Kodi ISPS), me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte” dhe me aktet nënligjore në fushën e sigurisë, të miratuara nga Autoriteti Shtetëror i Sigurisë.

FSAP-ja ka për detyrë:

a) mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, të objekteve dhe vlerave të portit;

b) krijimin e një mjedisi, të sigurisë dhe të përshtatshëm, për një punë të pandërprerë, 24-orëshe, me tre (3 turne) për Portin Detar dhe operatorët e ndryshëm, që veprojnë në këtë port.

3. Drejtori i Forcës së Sigurisë në Anije dhe Port i jep llogari, drejtpërdrejt, drejtorit të shoqërisë anonime, Porti, Detar, për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe anijet, që janë të ankoruara, në lëvizje nga dhe në drejtim të portit, ato të radës së portit, si dhe vepron sipas udhëzimeve të tij.

4. Kriteret profesionale dhe komisioni përkatës për përzgjedhjen (rekrutimin) e anëtarëve të FSAP-së hartohen nga shoqëria anonime, Porti Detar dhe miratohen nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

5. FSAP-ja është një forcë e armatosur dhe e pajisur me mjetet e nevojshme, për të siguruar portin dhe anijt nga çdo sulm i mundshëm, terrorist apo keqbërës, si dhe nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën objekt kontrolli të FSAP-së. Pajisjet, mjetet, uniforma dhe armatimi përshkruhen në aneksin 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. FSAP-ja, për çdo rast konstatimi të veprave penale, gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, siguron vendin e ngjarjes, provat materiale, bllokon autorët dhe njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe prokurorinë, duke bashkëvepruar me këto organe për vazhdimin e procedimit penal.

Gjithashtu, FSAP-ja, për çdo shkelje të natyrës doganore, i raporton, menjëherë, degës rajonale të doganave.

7. Komiteti i Sigurisë së Anijeve dhe Portit është organ kolegjal, i cili kryesohet nga drejtori i shoqërisë anonime, Porti Detar, dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Një përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.
- Një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Një përfaqësues të Ministrisë së Financave.
- Një përfaqësues të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë.
- Një përfaqësues të Drejtorisë së Politikave të Transportit Detar.
- Një përfaqësues të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë anonime, Porti Detar.
- Kapiteni i porteve.

8. Komiteti i Sigurisë së Anijeve dhe Portit vlerëson projektplanet e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port për zbatimin e tyre. Ky komitet mblidhet një herë në tre muaj. Me kërkesë të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë ose të shoqërisë anonime, Porti Detar mund të mblidhet në periudha më të shkurtra ose jashtë radhe.

9. Rregullat e brendshme të hollësishme për funksionimin e FSAP-së, në përputhje me këtë vendim dhe në mbështetje të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, miratohen nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë anonime, Porti Detar.


10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e shoqërisë anonime, Porti Detar.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Forca e sigurisë e SHA
Portit Detar



PËRSHKRIMI

I. ARMË

Pistoleta

Shkop zgjatues dhe mbajtës

II. TRANSPORT

Automjet

Mjet lundrues patrullues

III. NDËRLIDHJE

Radio stacionare VHF

Radio dore VHF

IV. UNIFORMA

Verore/dimërore

VENDIM
Nr.172, datë 28.3.2007

**PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS
“ROT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË E MINISTRISË SË
INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “WONDER” SHA, PËR
HIDROCENTRALIN E BOGOVËS, TË MIRATUAR ME VENDIM NR.609, DATË 11.9.2003
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit të formës “ROT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Wonder” sh.a., për hidrocentralin e Bogovës, të miratuar me vendim nr.609, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.609, datë 11.9.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe në tekstin e marrëveshjes bazë të koncesionit, të lidhur ndërmjet e Ministrisë së Ekonomisë e Ministrisë së Industrisë dhe energjetikës dhe shoqërisë “Wonder” sh.a., për hidrocentralin e Bogovës, fjalët “...Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë...” Zëvendësohen me “...Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHITESË KONCESIONI
PËR HIDROCENTRALIN BOGOVË-SKRAPAR

Në Tiranë, sot më datë 15.3.2007, Palët:

OSHA e përfaqësuar nga z. Zamir Stefani me autorizimin nr.387/3, datë 22.2.2007 të METE-s

dhe

shoqëria “Wonder” sh.a. Tiranë, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm i saj z.Vasil Gjika, me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit e formës ROT, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Wonder” sh.a. Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Bogovës në Skrapar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 11.9.2003.

HYRJE

Duke pasur parasysh që në marrëveshjen ekzistuese të koncesionit ka mangësi për të realizuar monitorimin e duhur të ecurisë së objektit të koncesionit, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në disa nene të marrëveshjes.

Palët bien dakord që në marrëveshjen bazë të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave

nr.609, datë 11.9.2003, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pas titullit, rreshti i parë i paragrafit të parë të marrëveshjes së koncesionit, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Wonder” sh.a. Tiranë, për rehabilitimin e hidrocentralit të Bogovës në Skrapar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.609, datë 11.9.2003, ndryshon si më poshtë:

“Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

Neni 2

Në nenin 4 “Detyrimet dhe të drejtat e koncesionarit”, te “Të drejtat e koncesionarit”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Koncesionari ka të drejtë të rrisë kapacitetin e prurjeve të ujit, duke përfshirë edhe burime të reja, përveç burimeve ekzistuese”.

Neni 3

Pas nenit 8, të shtohet një nen i ri me titull “Përdorimi i ujit” me këtë përmbajtje:

- “Për shfrytëzimin racional të ujit të burimeve të Bogovës, ndërmarrja e ujësjellësit Berat është e autorizuar të hartojë me koncesionarin një marrëveshje përdorimi të këtyre ujërave, ku të përcaktohen kuotat e shfrytëzimit nga të dyja Palët, si dhe mënyra e rregullimit të tyre.”

- “Për përdorimin me efikasitet të ujit, ndërmarrja e ujësjellësit Berat, në bashkëpunim me koncesionarin, autorizohen të hartojnë projektin për ndërtimin e një stacioni pompimi në dalje të bjeftit të poshtëm të HEC-it të Bogovës, me qëllim dërgimin e ujit në tubacionin kryesor të ujësjellësit.”

Neni 4

Në nenin 10 “Programi i punimeve”,

- pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“Afati i përfundimit të investimeve, i përcaktuar në anekset 2 dhe 3, shtyhen deri në datën 31.12.2006.”

- Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2007 deri në fund të periudhës koncesionare është jo më pak se prodhimi i përcaktuar në aneksin 2 në kolonën: viti 2005-2006.

Ndryshimi i programit vjetor të prodhimit mund të bëhet me miratim të OSHA-së, në rastet e ndryshimit të parametrevave teknike të objektit.”

Neni 5

Në nenin 14 “Kontrolli i përgjithshëm”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“OSHA ushtron kontroll në objektin e dhënë me koncesion edhe gjatë kohës së shfrytëzimit, pas përfundimit të rehabilitimit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Kontrolli kryhet nga persona të autorizuar nga OSHA-ja me qëllim verifikimin e shfrytëzimit dhe prodhimit, sipas parametrevave teknike të objektit të dhënë me koncesion, si dhe kryerjen e remonteve të parashikuara në udhëzimet e shfrytëzimit të pajisjeve.”

Neni 6

Në nenin 20 “Zbatimi i projektit” pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Me përfundimin e zbatimit të projektit rehabilitues mbi objektin e koncesionit, koncesionari është i detyruar që në fund të çdo tremujori, dhe sa herë e kërkon OSHA-ja, të raportojë me shkrim mbi ecurinë e punës në objekt, sipas një formulari që do të dërgohet nga OSHA-ja.”

Neni 7

Në nenin 22 “Sanksionet”

- në paragrafin e dytë, fjalët “pika 1” zëvendësohen me fjalët “pika 2”;
- pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rast mosrealizimi të programit të prodhimit, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, koncesionari penalizohet me 0.01% të vlerës së prodhimit të përcaktuar për periudhën raportuese.”.

Neni 8

Marrëveshja shtesë e koncesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimet e përshkuara në nenet 1-8 më lart, kanë fuqi për të dyja Palët.

Nenet e tjera të marrëveshjes bazë nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja shtesë e koncesionit mbahet në 7 (shtatë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja Palët.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
PËRFAQËSUESI ME AUTORIZIM
Zamir Stefani

Për koncesionarin
Shoqëria “Wonder” sh.a.
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Vasil Gjika

VENDIM

Nr.182, datë 4.4.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “LABINOT MAL-ELBASAN” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 27, pika 3. shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie, me koncesion, të formës “ROT” (rehabilitim, Operim dhe Transferim), të hidrocentralit ekzistues “Labinot Mal-Elbasan”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënie e bonusit prej 8 përqindësh të pikëve shoqërisë “KORRA”, sh.p.k., për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.183, datë 28.3.2007

PËR ORGANIZIMIN, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E BILETAVE NË TRANSPORTIN RRUGOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar dhe të nenit 12, të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Formati i biletave të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, për shërbimin qytetas, ndërqytetas, rrethqytetas, si dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve duhet të jetë në format standard dhe i pajisur me numrin serial përkatës.

2. Çmimi i biletave të transportit të udhëtarëve, i cili përmban edhe vlerën e TVSH-së, vendoset në përputhje me ligjin nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, si dhe me vendimin nr.146, datë 26.2.1998, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për emetimin e biletave të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, për shërbimin qytetas, ndërqytetas, rrethqytetas dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Printimi i biletave të transportit të udhëtarëve të realizohet nga organet e specializuara për prodhimin e tyre, në bazë të kontratës ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4. Pajisja me bileta tatimore e udhëtarëve të kryhet për të gjitha llojet e shërbimit të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, përjashtuar taksitë 4+1 dhe 8+1. Matja e vëllimit të punës për taksitë 4+1 dhe 8+1 të kryhet nëpërmjet taksimetrit, me tregues fiskal.

5. Agjencitë e udhëtarëve realizojnë tërheqjen e biletave të transportit të udhëtarëve dhe të faturave përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo degët e tyre në rrethe, kundrejt kostos së prodhimit të tyre.

6. Çdo fund viti kalendarik, agjencitë e transportit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar paraqesin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kërkesat për sasinë e biletave, për vitin e ardhshëm fiskal.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mbështetje të nenit 36, të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.8308, datë 18.3.1999, “Për transportin rrugor”, nënshkruan aktmarrëveshje me shoqatat e transportit të udhëtarëve, për bashkërendimin e punës për sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e transportit rrugor.

8. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2007, t’i jepet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për emetimin e biletave të transportit, në zbatim të këtij vendimi.

9. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve, në zbatim të këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, nëpërmjet Policisë Tatimore, në bashkëpunim me strukturat përkatëse për kontrollin e transportit të udhëtarëve, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre funksionale.

12. Pika 1.11, e vendimit nr.473, datë 29.7.1998, “Për rregullat kryesore të veprimtarisë së agjencive të transportit të udhëtarëve dhe të transportuesve që kryejnë transportin me autobus”, shfuqizohet.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 17.4.2007
 Doli nga shtypi më 19.4.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë